



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PËRMBUSHJES SË CAQEVE 2015

VLERËSIMI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË KRU`ve TË PËRCAKTUARA NGA
ARRU PËR VITIN 2015 NGA PROCESI RREGULLATOR I TARIFAVE 2015-2017

Periudha raportuese: Janar – Dhjetor 2015

DFTRR/ARRU

Prishtinë, Qershor 2016

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efëiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

1	HYRJE	5
2	SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE	6
3	APLIKIMI I INFLACIONIT	7
4	METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE.....	8
5.	ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT	9
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	10
5.1.	Analiza e humbjeve të ujit	12
6.	ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE.....	13
6. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	14
6.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza	15
6.2	Shpenzimet e pagave dhe të energjisë elektrike.....	16
6.3	Mbulimi i shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale vetanake nga shuma e arkëtimit .	17
7.	SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE	18
7.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	19
7.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza	20
7.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza	21
7.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza	22
8.	INVESTIMET KAPITALE	23
8.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	24
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive	27
8.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	28
8.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	31
9.	RANGIMI I KRU-VE SIPAS REALIZIMIT TË CAQEVE	32
9.1	Rangimi individual sipas kriterit të përmbushjes së caqeve	34
9.2	Rangimi i KRU-ve sipas performances me te mirë të përmbushjes së caqeve	41
10.	KONKLuzionet E RAPORTIT	42
11.	Shtojca Nr.1: Hartat e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit	44

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit
FE	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Bifurkacioni” sh. a –Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Radoniqi” sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Hidromorava” sh. a – Gjilan
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Mitrovica” sh. a – Mitrovicë
PE	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Hidrodrini” sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Prishtina” sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “Hidroregjioni-Jugor” sh. a – Prizren
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve

1 HYRJE

Sipas praktikave të mira të përvetësuar nga ARRU edhe kësaj radhe kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor të vitit 2015 me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve, të procesit rregullatorë të tarifave afatmesme 2015-2017. Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave gjatë vitit 2015 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovua nga procesi tarifaror 2015-2017, për vitin 2015, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për të njëjtën periudhë kohore të vitit 2015 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ARRU. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur në vitin 2014.

Qëllimi i këtij raporti është:

- (i) Të jepet informacion për shkallën e arritshmerisë së treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për periudhën e shikuar kohore të vitit 2015.
- (ii) Krahasimi i treguesve të KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tarifarorë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendet e tilla gjatë vitit pasues biznesor të vitit 2016 nga procesi rregullatorë i tarifave 2015-2017.

Duke pasur parasysh se KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Parimi bazë i procesit rregullatorë të tarifave të periudhës tarifore 2015-2017 është krijimi i parakushteve për një qëndrueshmëri ma të mirë financiare për kompanitë, që nënkupton; kosto optimale operative për sasi dhe cilësi të caktuar shërbimi për konsumatorët e shërbyer, të cilat kemi shpresuar dhe shpresojmë se do të arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për t'u paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të performancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ARRU, mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne, besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale të ujit, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relaçione optimale.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar ngadalë , vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2015-2017.

Prandaj, ARRU do të kryej monitorimin e rregullt gjatë gjithë periudhës së mbetur tarifore 2016-2017 për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator, siç po bëjmë edhe me këtë raport dhe për rishikime eventuale të politikave të ardhshme tarifore.

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

ASK e llogarit Indeksit e Çmimeve të Konsumit duke grumbulluar informacion të çmimeve për artikuj të ndryshëm në të gjithë territorin e vendit. Si i tillë inflacioni paraqet një rritje/zbritje ngulmuese e çmimit të të mirave dhe shërbimeve shkaktuar nga një sasi e vogël e të mirave materiale në treg dhe e një sasive të madhe të parasë në qarkullim.

ARRU i kushton kujdes të veçantë aplikimit të inflacionit në të dhënat financiare të KRU-ve të dorëzuara përgjatë procesit tarifor, pasi që qëllimi i këtij raporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017, për vitin 2015, dhe për të qenë vlerësimi sa më real, të dhënat financiare të aprovuara nga ARRU të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeksit e Çmimeve të Konsumit në Kosovë.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për vitin 2015 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2014 (Qershor 2014 = kur IÇKK-ja ishte 127.3), ngase BPRR për procesin tarifor 2015-2017 janë dorëzuara gjatë asaj kohe, të cilat gjatë procesit të përcaktimit të tarifave të vitit 2015 janë indeksuar me Indeksit e Konsumit të Çmimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të sqaruar në paragrafin 4 të kësaj pjese.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ARRU ndryshojnë prej të dhënave financiare që gjenden në BPRR-ët e KRU-ve, por të njëjtat janë të njoftuara në detaje me shumat e tilla financiare pas indeksimit, pasi që të gjitha kompanitë individualisht i kanë marr raportet përmbyllëse tarifore të vitit 2015-2017. Dallimet e evidentuara të dy periudhave janë të vogla në vlera absolute, por të njëjtat janë pasqyruar për shkak të korrektësisë së llogaritjeve dhe raportimit të saktë.

Të dhënat financiare të aprovuara për vitin 2015, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ve duke i shumëzuar me IÇKK 0.99673. Ky indeks është fituar duke pjesëtuar mesataren e IÇKK-së të vitit 2015 (126.883) me IÇKK-ën e mesit të vitit 2014 (127.3).

Sikurse edhe u theksua më lartë qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017 gjatë vitit 2015.

4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017 për vitin 2015, ka qenë e ngjashme uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë vitit 2014,
- të dhënat e aprovuara nga ARRU për vitin 2015,
- të dhënat e realizuara nga KRU gjatë vitit 2015,
- përqindja krahasuese e vitit 2015 me vitin 2014,
- përqindja krahasuese e realizimit të caktit të vitit 2015, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese e vitit 2015 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2014 është raporti i të dhënave të dala nga treguesit e arritur të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja krahasuese e realizimit të caktit për vitin 2015 del si rezultat i raportit të dhënave të aprovuara me të dhënat e realizuara dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për vitin 2015 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i ARRU-së, dhe identifikohet si:

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat e ujit të humbur dhe shpenzimeve operative në m³.

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
< 98.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.00% - 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
102.01%- 106.00%	P	E përafuar	Negativ
> 106.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat tjera

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
> 102.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.01% – 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
94.00% – 98.00%	P	E përafuar	Negativ
<94.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

5. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve prej nga është bërë krahasimi i të dhënave të realizuara me ato historike si dhe të dhënave të realizuara me të dhënat e aprovuara, me të cilat njëherit bëhet edhe vlerësimi i përbushjes së caqeve.


Tabela Nr. 1. Të dhënat për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer gjatë vitit 2015 krahasuar me të dhënat e vitit 2014 dhe me caqet e përcaktuara për vitin 2015.

Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësia matëse	Historike 2014	Aprovuara 2015	Realizuara nga KRU-të 2015	% krahasuese 2015/2014	% real cak 2015	Vlerësimi për 2015
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	37,554,887	44,166,663	41,282,430	109.93%	93.47%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	18,452,520	19,780,652	20,899,398	113.26%	105.66%	P
	Uji i faturuar	m ³	19,102,367	24,386,011	20,383,032	106.70%	83.58%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	107,892	106,207	113,848	105.52%	107.19%	P
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	17,482,699	20,616,867	17,308,689	99.00%	83.95%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	9,063,577	11,675,786	10,010,227	110.44%	85.73%	P
	Uji i faturuar	m ³	8,419,122	8,941,081	7,298,462	86.69%	81.63%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	41,157	43,059	42,761	103.90%	99.31%	R
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	29,782,872	25,547,250	25,559,988	85.82%	100.05%	R
	Uji i humbur	m ³	21,095,517	15,857,250	16,776,858	79.53%	105.80%	P
	Uji i faturuar	m ³	8,687,355	9,690,000	8,783,130	101.10%	90.64%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	40,275	39,491	43,199	107.26%	109.39%	P
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	19,562,012	17,934,196	23,154,548	118.36%	129.11%	P
	Uji i humbur	m ³	11,544,636	7,052,993	13,884,319	120.27%	196.86%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	8,017,376	10,881,202	9,270,229	115.63%	85.19%	Jo e R
	Faturimi-Jug	m ³	4,343,571	6,181,202	4,562,790	105.05%	73.82%	Jo e R
	Faturimi-Veri	m ³	3,673,805	4,700,000	4,707,439	128.14%	100.16%	R
	Konsumatorët	Nr	22,825	25,024	26,192	114.75%	104.67%	P
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	13,527,221	14,127,388	13,721,967	101.44%	97.13%	P
	Uji i humbur	m ³	6,827,068	6,677,017	6,642,820	97.30%	99.49%	R
	Uji i faturuar	m ³	6,700,153	7,450,371	7,079,147	105.66%	95.02%	P
	Konsumatorët	Nr	30,957	30,213	32,935	106.39%	109.01%	P
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	6,325,018	7,521,972	7,481,265	118.28%	99.46%	R
	Uji i humbur	m ³	3,332,033	3,479,717	3,905,572	117.21%	112.24%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,992,985	4,042,255	3,575,693	119.47%	88.46%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	19,142	22,648	23,540	122.98%	103.94%	P
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	7,593,458	7,733,190	8,535,394	112.40%	110.37%	P
	Uji i humbur	m ³	4,424,105	3,797,000	5,181,472	117.12%	136.46%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	3,169,353	3,936,190	3,353,922	105.82%	85.21%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	24,737	23,621	23,575	95.30%	99.81%	R
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	131,828,16	137,647,52	137,044,28	103.96%	99.56%	R
	Uji i humbur	m ³	74,739,456	68,320,416	77,300,666	103.43%	113.14%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	57,088,711	69,327,111	59,743,615	104.65%	86.18%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	286,985	290,262	300,032	104.55%	103.37%	P


5.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike të vitit 2014 me të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe të dhënat e realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2015.


Uji i prodhuar në m³




Uji i humbur në m³




Uji i faturuar në m³



Konsumatorët



Përqindja e ujit të prodhuar e cila kthehet në para



Diagrami i më sipërm paraqet në mënyrë grafike efikasitetin e secilës KRU në Kosovë se sa arrin atë të kthejnë në para sasinë e ujit të prodhuar në m³.

Nga kjo analizë mund të konstatojmë se ndër kompanitë që është treguar më efektive në këtë aspekt është KRU "Radoniqi" sh. a. Gjakovë e cila arrin që 43 % të sasië së ujit që prodhon ta kthej në para të arkëtueshme, e që pason pastaj nga KRU "Prishtina" sh. a. Prishtinë me 37%.


Sa për ilustrim, hapësira që rrijohet në mes të lakorës me ngjyrë të gjelbër dhe asaj me ngjyrë të kaltër, tregon figurativisht shumën e sasisë së ujit të prodhuar për të cilat sektori i ujit në Kosovë hargjon mjete financiare për prodhim por që nuk arrin t'a kthejë në para.

5.1. Analiza e humbjeve të ujit

Në takimin e përbashkët mbajtur gjatë muajt shtator 2015 në Prishtinë në mes të përfaqësuesve të ARRU-së dhe zyrtarëve të KRU-ve, u diskutuan të gjeturat nga raporti 6 mujor i përmbushjes së caqeve, si kërkesë e KRU-ve ishte që të paraqiten humbjet e ujit ndaras në një tabelë, dhe pastaj të bëhet rangimi i KRU-ve. Ne si ARRU kemi përdorur këtë qasje sa i përket humbjeve të ujit, dhe si rangim kemi përdorur kriterin e humbjeve të ujit për metër ate me gjatësin e gypave. Kuptohet se kjo analize do ishte relative nëse të dhënat nuk janë raportuar saktë nga ana e KRU-ve. Si kompania më e mirë që menaxhon me humbjet e ujit në Kosovë është **KRU “Prishtina” Prishtina, e cila përcillet për së afërmi nga KRU “Radoniqi”Gjakovë**, ndërsa si kompania më e dobët në këtë aspekt është KRU “Hidrodrini” Pejë.

Tabela. Nr. 1.1. Analiza e humbjeve të ujit për metër gjatësi të gypave për vitin 2015

Selit e kompanive	Prodhimi i ujit në m ³	Humbjet e ujit në m ³	Përqindja e humbjeve të ujit	Mesatarja e rrjetit të ujësjellësit në km. gjatësi	Raporti i humbjeve në m ³ për metër gjatësi të rrjetit
PR	41,282,430	20,899,398	50.63%	1,700	12.29
PZ	17,308,689	10,010,227	57.83%	509	19.65
PE	25,559,988	16,776,858	65.64%	592	28.34
MIT	23,154,548	13,884,319	59.96%	695	19.98
GJA	13,721,967	6,642,820	48.41%	540	12.30
FE	7,481,265	3,905,572	52.20%	227	17.21
GJI	8,535,394	5,181,472	60.71%	279	18.57
Sektori	137,044,281	77,300,666	56.41%	4,542	17.0



6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor 2015-2017, ARRU ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ARRU (www.arru-rks.org).


6.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektorin, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike të vitit 2014, ato të aprovuara nga ARRU si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2015, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €


Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Valuta	Historike 2014	Aprovuara nga ARRU 2015	Realizuara nga KRU 2015	% Krahasues e viteve 2015/2014	% e realizmit të caktut 2015	Vlerësimi përfundimtar për vitin 2015
Prishtina (PR)	Ujë	€	8,814,489	7,274,187	8,830,840	100.19%	121.40%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	305,082	520,650	165,972	54.40%	31.88%	P
	Totali	€	9,119,571	7,794,838	8,996,812	98.65%	115.42%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,895,484	3,028,373	2,831,779	97.80%	93.51%	P
	Ujëra të Zeza	€	173,000	204,856	413,440	238.98%	201.82%	Jo e R
	Totali	€	3,068,484	3,233,230	3,245,219	105.76%	100.37%	R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,006,959	1,943,559	2,073,805	103.33%	106.70%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	105,443	122,086	130,021	123.31%	106.50%	Jo e R
	Totali	€	2,112,402	2,065,645	2,203,826	104.33%	106.69%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	1,874,796	2,101,371	2,115,556	112.84%	100.68%	R
	Ujëra të Zeza	€	100,861	195,350	342,366	339.44%	175.26%	Jo e R
	Totali	€	1,975,657	2,296,721	2,457,922	124.41%	107.02%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	2,302,587	2,090,831	2,391,361	103.86%	114.37%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	182,452	252,382	187,978	103.03%	74.48%	P
	Totali	€	2,485,039	2,343,212	2,579,339	103.79%	110.08%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	1,060,570	1,095,483	1,331,980	125.59%	121.59%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	87,355	156,191	112,056	128.28%	71.74%	P
	Totali	€	1,147,925	1,251,674	1,444,036	125.80%	115.37%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,252,275	1,127,764	1,333,395	106.48%	118.23%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	119,344	105,296	133,435	111.81%	126.72%	Jo e R
	Totali	€	1,371,619	1,233,060	1,466,830	106.94%	118.96%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	20,207,160	18,661,568	20,908,716	103.47%	112.04%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,073,537	1,556,812	1,485,268	138.35%	95.40%	P
Totali i përgjithshëm sektorial		€	21,280,697	20,218,380	22,393,984	105.23%	110.76%	Jo e R

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur gjatë vitit 2015, 93.37% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 6.63 % janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të gjatë vitit 2015 është 22,393,984€, të cilat si të tilla janë tejkaluar nga shuma e aprovuar nga ARRU për këtë periudhë në lartësi prej 10.76%.




6.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza


Shpenzimet operative për ujë



Shpenzimet operative për kanalizim



Përqindja e realizimit të shpenzimeve operative nga KRU-të




Nga grafikoni i mësipërm vërehet se vetëm KRU “Hidroregjioni-Jugor” Prizren ka arritur t’i mbaj në kontroll shpenzimet e ujit dhe kanalizimit, gjatë vitit 2015.

6.2 Shpenzimet e pagave dhe të energjisë elektrike

Është e ditur se kostoja e pagave për të punësuarit në të gjitha KRU-të paraqesin zërat më të larta të tyre dhe për t'i pasqyruar të njëjtat në raport me kostot tjera po i paraqesim në Tabelën e më poshtme, prej nga mund të kuptojmë lehtë se cila kompani menaxhon më mirë me zërin e pagave. Pasi dihet që ky zë i kostove është më ndikuesi, sikurse po paraqesim edhe pagat mesatare për secilën kompani dhe për sektorin.

Tabela Nr. 3 Shpenzimet e pagave dhe të energjisë në raport me shpenzimet totale për vitin 2015

Emri i Kompanisë	Totali i shpenzimeve e operative të realiz.	Shpenzimet e pagave të realizuara	Shpenzimet e energjisë elektrike	Numri i të punësuarve	Përqindja e pagave në raport me shpenzimet e realizuara	Paga mesatare mujore
	€	€	€	Nr	%	€/muaj
PRISHTINA	8,996,812	4,874,771	2,468,229	544	54.18%	747
HIDROREGJIONI-JUGOR	3,245,219	1,885,103	782,356	310	58.09%	507
HIDRODRINI	2,203,826	1,397,151	491,903	216	63.40%	539
MITROVICA	2,457,922	1,411,190	448,700	225	57.41%	523
RADONIQI	2,579,339	1,917,317	255,829	269	74.33%	594
BIFURKACIONI	1,444,036	1,028,426	160,035	185	71.22%	463
HIDROMORAVA	1,466,830	957,580	231,608	160	65.28%	499
SEKTORI	22,393,984	13,471,538	4,838,660	1,909	60.16%	642



Prej të dhënave të mësipërme mund të kuptojmë se për sektorin e ujit në Kosovë gjatë vitit 2015, 60.2% të shpenzimeve e përbëjnë pagat, kurse me 21.6% energjia elektrike, ndërsa pjesa tjetër përmban shpenzimet tjera operative.


6.3 Mbulimi i shpenzimeve operative dhe të investimeve kapitale vetanake nga shuma e arkëtimit

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat e shumës së shpenzimeve të ndodhura për çdo kompani veç e veç dhe shumës së arkëtimit për vitin 2015, në të cilën paraqitet shkalla e mbulueshmërisë së shpenzimeve operative pa amortizim me arkëtim dhe shkallës së mbulueshmërisë së shpenzimeve operative pa amortizim dhe me investime kapitale.. E njëjta tregon të dhënën e efijencës së çdo kompanie dhe sektorit përgjatë periudhës së shikuar.

Tabela Nr.4 Pasqyra e të dhënave të mbulueshmërisë së të hyrave të arkëtuara me shpenzimet e përgjithshme operative pa amortizim dhe investimeve kapitale vetanake për vitin 2015

Emri i kompanisë	Arkëtimi €	Shpenzimet operative pa amortizim €	Mbetja financiare €	Investimet kapitale vetanake €	Shkalla e mbulueshmërisë se shpenzimeve operative pa amortizim me arkëtim €	Shkalla e mbulueshmërisë se shpenzimeve operative dhe investimeve pa amortizim. me arkëtim €
	A	B	C=(A-B)	D	E=A/B	F=A/(B+D)
PRISHTINA	9,609,57	8,996,812	612,761	728,621	1.07	0.99
HIDROREGJIONI-JUGOR	3,036,61	3,245,219	-208,605	132,501	0.94	0.90
HIDRODRINI	2,504,32	2,203,826	300,497	247,991	1.14	1.02
MITROVICA	1,803,03	2,457,922	-654,891	0	0.73	0.73
RADONIQI	3,135,60	2,579,339	556,263	664,956	1.22	0.97
BIFURKACIONI	1,436,17	1,444,036	-7,863	117,900	0.99	0.92
HIDROMORAVA	1,452,57	1,466,830	-14,260	34,104	0.99	0.97
SEKTORI	22,977,8	22,393,984	583,902	1,926,073	1.03	0.94

Analiza e mbetjes financiare



Nga kjo analizë si dhe nga grafikoni i paraqitur më sipër, KRU "Hidroregjioni-Jugor" Prizren dhe KRU "Mitrovica" Mitrovicë kanë pasur më shumë shpenzime sesa të hyra, prandaj edhe bilanci i tyre financiar është negativ në masë të konsiderueshme, duke pasur me një bilanc të lehtë negativ për KRU "Bifurkacini" Ferizaj dhe KRU "Hidromorava" Gjilan.

7. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga secila kompani në veçanti dhe sektorit në përgjithësi, në të cilat hynë të dhënat historike të realizuar gjatë vitit 2014, pastaj të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2015, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2015-2017.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për vitin 2015 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë të njëjtës periudhë të këtij viti me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2014.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ARRU në Mars të vitit 2014, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetrike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim atribuohet si e vetme për shërbimin e ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ARRU ka qenë e detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ARRU-KRU dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit (subvencione), që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ARRU-ës të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.


7.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të vitit 2014, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori gjatë vitit 2015.

Tabela Nr. 5 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Valuta	Historike 2014	Aprovuara nga ARRU 2015	Realizuara nga KRU 2015	% Krahas. 2015/2014	% e real. të caktut 2015	Vlerësi mi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	10,710,716	13,158,142	11,587,912	108.19	88.07%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,053,246	1,281,621	1,137,772	108.03	88.78%	Jo e R
	Totali	€	11,763,962	14,439,764	12,725,684	108.18	88.13%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	3,597,418	4,290,063	3,651,899	101.51	85.12%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	360,829	502,296	439,721	121.86	87.54%	Jo e R
	Totali	€	3,958,247	4,792,360	4,091,620	103.37	85.38%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,987,956	3,267,352	3,130,347	104.77	95.81%	P
	Ujëra të Zeza	€	323,543	326,665	312,148	96.48%	95.56%	P
	Totali	€	3,311,499	3,594,017	3,442,495	103.96	95.78%	P
Mitrovica (MIT)	Ujë-Jugu	€	2,040,761	2,738,431	2,169,386	106.30	79.22%	Jo e R
	Ujë-Veriu	€	624,547	799,108	800,409	128.16	100.16%	R
	Ujëra të Zeza	€	413,019	491,907	439,409	106.39	89.33%	Jo e R
	Totali¹	€	2,453,780	3,230,338	2,608,795	106.32	80.76%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	3,018,617	3,371,524	3,238,990	107.30	96.07%	P
	Ujëra të Zeza	€	382,697	445,117	512,941	134.03	115.24%	T P
	Totali	€	3,401,314	3,816,642	3,751,931	110.31	98.30%	R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	1,425,013	1,789,343	1,735,876	121.81	97.01%	P
	Ujëra të Zeza	€	324,078	545,074	457,461	141.16	83.93%	Jo e R
	Totali	€	1,749,091	2,334,416	2,193,337	125.40	93.96%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,478,280	1,755,478	1,571,227	106.29	89.50%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	268,432	267,009	282,510	105.24	105.81%	T P
	Totali	€	1,746,712	2,022,487	1,853,737	106.13	91.66%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	25,258,761	31,169,442	27,886,046	110.40	89.47%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	3,125,844	3,859,690	3,581,962	114.59	92.80%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	28,384,605	35,029,132	31,468,008	110.86	89.83%	Jo e R


Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë, 88.62 % të shumës së faturimit në vlerë financiare realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 11.38% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë vitit 2015 është realizuar faturimi në vlerë prej 31,468,008€, e që paraqet 89.83% të shumës së aprovuar nga procesi rregullatorë për vitin 2015.




¹ Në këtë pikë, totali nuk përmban edhe sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturara për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

7.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza


Faturimi për ujë në euro



Faturimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të faturimit në Euro



Sipas vlerësimit të ARRU-së, KRU "Radoniqi" është e vetmja kompani që ka realizuar këtë cak në masën prej 98,3%, ku vlen të theksohet edhe përafrimi i KRU "Hidrodrini" në masën prej 95,78%.

7.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza


Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të vitit 2014, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2015.

Tabela Nr. 6

Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Arkëtimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2014	Aprovuara nga ARRU 2015	Realizuara nga KRU 2015	% krahasuese 2015/2014	% e real. të caktut 2015	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	8,534,652	10,247,044	8,750,405	102.53%	85.39%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	839,261	1,010,190	859,168	102.37%	85.05%	Jo e R
	Totali	€	9,373,913	11,257,233	9,609,573	102.51%	85.36%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,715,196	3,352,743	2,710,273	99.82%	80.84%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	272,340	397,380	326,341	119.83%	82.12%	Jo e R
	Totali	€	2,987,537	3,750,123	3,036,614	101.64%	80.97%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,020,573	2,377,873	2,277,244	112.70%	95.77%	P
	Ujëra të Zeza	€	218,793	247,415	227,079	103.79%	91.78%	Jo e R
	Totali	€	2,239,366	2,625,289	2,504,323	111.83%	95.39%	P
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	986,588	1,597,176	1,210,454	122.69%	75.79%	Jo e R
	Subvencionet	€	1,108,857	520,000	347,400	31.33%	66.81%	Jo e R
	Ujërat e zeza	€	199,671	301,664	245,177	122.79%	81.27%	Jo e R
Totali²	€	1,186,259	1,898,840	1,455,631	122.71%	76.66%	Jo e R	
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	2,496,926	2,572,469	2,706,922	108.41%	105.23%	P
	Ujëra të Zeza	€	316,557	344,891	428,680	135.42%	124.29%	P
	Totali	€	2,813,483	2,917,360	3,135,602	111.45%	107.48%	P
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	907,900	1,246,384	1,136,633	125.19%	91.19%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	206,476	382,757	299,540	145.07%	78.26%	Jo e R
	Totali	€	1,114,376	1,629,141	1,436,173	128.88%	88.16%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,069,336	1,362,211	1,231,198	115.14%	90.38%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	194,174	209,216	221,372	114.01%	105.81%	P
	Totali	€	1,263,510	1,571,427	1,452,570	114.96%	92.44%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	18,731,172	22,755,900	20,023,127	106.90%	87.99%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	2,247,272	2,893,513	2,607,359	116.02%	90.11%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial	€	20,978,444	25,649,413	22,630,486	107.87%	88.23%	Jo e R	


Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ARRU-sëtë vitit 2015, 88.48% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 11.52% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total, gjatë vitit 2015 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 22,630,486€, e që paraqet 88.23 % të shumës së aprovuar gjatë procesit tarifor 2015-2017, për vitin 2015.




² Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e ujit të trajtuar me shumicë për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës, nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

7.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza


Arkëtimi për ujë në euro



Arkëtimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të arkëtimit në Euro



Sic edhe vërehet nga diagrami, e vetmja KRU e cila ka realizuar dhe tejkaluar cakun e arkëtimit është KRU “Radoniqi” Gjakovë për cka meriton të komplimentohet, pasi është i vetmi rast prej se është krijuar Rregullatori, ku vlen të përmendet edhe angazhimi i KRU “Hidrodrini” Pejë që ka përbush këtë cak në masën prej 95.39%.

8. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2015-2017, ARRU-KRU kanë planifikuar realizimin e shumave të caktuara të investimeve, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU.

8.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit gjatë vitit 2015. Me këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU me ato të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2015, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

Tabela Nr. 7. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë në vitin 2015 shprehur në €

Emri i kompanisë	Kategori të Investimeve	Aprovuara 2015	Realizuara 2015	% e real. të caktut 2015	Vlerësimi përfundimtar
PRISHTINA	Resurse dhe trajtimi i	976,792	49,686	5.09%	Jo e R
	Distribuim	1,078,956	243,822	22.60%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	890,625	416,051	46.71%	Jo e R
	Totali	2,946,374	709,559	24.08%	Jo e R
Hidroregjioni-Jugor	Resurse dhe trajtimi i	94,689	82,775	87.42%	Jo e R
	Distribuim	112,630	22,794	20.24%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	15,866	25,847	162.91%	T P
	Totali	223,185	131,416	58.88%	Jo e R
Hidrodrini	Resurse dhe trajtimi i	14,951	0	0.00%	Jo e R
	Distribuim	543,715	68,013	12.51%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	144,525	161,575	111.80%	T P
	Totali	703,191	229,588	32.65%	Jo e R
Mitrovica	Resurse dhe trajtimi i	0	0	!	E pa K
	Distribuim	0	0	!	E pa K
	Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
	Totali	0	0	!	E pa K
Radoniqi	Resurse dhe trajtimi i	299,018	319,848	106.97%	T P
	Distribuim	99,673	240,052	240.84%	T P
	Aktivitetet biznesore	64,289	91,524	142.36%	T P
	Totali	462,980	651,424	140.70%	T P
Bifurkacioni	Resurse dhe trajtimi i	138,545	44,661	32.24%	Jo e R
	Distribuim	119,607	31,950	26.71%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	2,990	28,785	962.65%	T P
	Totali	261,142	105,396	40.36%	Jo e R
